



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.11.2018, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017".

2. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it".

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia. Luan Duzha, Luan Harusha, Paulin Sterkaj, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Anduel Xhindi, Klodjana Spahiu dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Elona Hoxha, Myslym Murrizi, Ervin Saliç, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunkshi, Isuf Çelaj.

Të ftuar:

Gazmend Barbullushi – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Cekani – Drejtoreshë e Fondeve IPA në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Migena Baholli - Specialiste në Drejtorinë e Traktateve në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Besmir Beja – Këshilltar

Odetta Thëngjilli - Drejtorja për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor

Eljona Bylykbashi – Përgjegjëse e Sektorit të Reformave dhe Përafrimit të Legjislacionit

Manuela Imeraj - Oficere e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë.

Jonad Bara - Oficer i Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Hapim mbledhjen e Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare. Në mbledhjen e sotme të komisionit, kemi planifikuar 2 projekt marrëveshje:

1. “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”.

2. "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017".

Pa humbur kohë fillojmë me prezantimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”.

Të ftuar për të bërë prezantimin e këtij projektligji kemi të pranishëm nga Ministria e Drejtësisë, zotin Besmir Beja, këshilltar, zonjën Odeta Thëngjilli nga Drejtoria për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor dhe zonjën Eljona Bylykbashi, përgjegjëse e Sektorit të Reformave dhe Përafrimit të Legjislacionit.

Meqenëse marrëveshja me Eurojust-in bën përgjegjëse për prokurimin Drejtorinë e Përgjithshme, kemi ftuar edhe dy përfaqësues të saj: Manuela Imeraj, oficer e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe zotin Jonad Bara, oficer i Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë.

Relator i komisionit për projektligjin është zoti Xhemal Qefalia.

Fjalën e ka zoti Beja për prezantimin e marrëveshjes.

Besmir Beja - Faleminderit zonja kryetare!

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it. Kjo marrëveshje ka si qëllim përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor, si dhe lehtësimin e bashkërendimit të hetimeve e të ndjekjeve penale, që shtrihen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe një ose më shumë shteteve anëtare të Bashkimit European.

Ratifikimi i marrëveshjes është në përputhje me politikat e qeverisë shqiptare, për t'u angazhuar intensivisht dhe në mënyrë të qëndrueshme për goditjen e krimit të organizuar dhe të trafikut të qenieve njerëzore e substancave narkotike, në respekt të plotë të ligjeve të vendit dhe të angazhimeve të saj ndërkombëtare.

Eurojust-i është një organizëm gjyqësor europian, që bashkërendon të gjitha hetimet kundër formave të rënda të krimit të organizuar. Ai mund t'u japë një shtysë hetimeve dhe mund t'u kërkojë autoriteteve të shteteve palë të marrëveshjes të vlerësojnë mundësinë e krijimit të skuadrave hetimore të përbashkëta dhe të sigurojnë informacione të ndërsjella mes autoriteteve të përfshira në rastet e veçanta.

Marrëveshja me Eurojust-in do të sjellë një hap cilësor në kryerjen e hetimeve transnacionale edhe me ndihmën e prokurorit të posaçëm ndërlidhës pranë strukturës së Eurojust-it në Hagë.

Lidhja e marrëveshjes me Eurojust-in do të nxisë bashkërendimin real mes hetimeve në më shumë se një shtet anëtar përmes shkëmbimit të menjëhershëm të akteve, dokumenteve dhe informacionit.

Hyrja në fuqi e marrëveshjes me Eurojust-in do t'ju mundësojë prokurorëve shqiptarë të forcojnë bashkëpunimin me kolegët e tyre nga vendet që aderojnë në këtë strukturë duke përfshirë edhe bashkëpunimin me vendet partnere në rajon, si Maqedonia dhe Mali i Zi, si dhe do të rrisë shkëmbimin e informacioneve gjyqësore edhe nëpërmjet pranisë së përhershme të prokurorit të posaçëm ndërlidhës pranë strukturës së Eurojust-it në Hagë. Kjo do të kontribuojë drejtpërdrejt në rezultatet e përbashkëta në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, do të rrisë besimin në kapacitetet tona hetimore dhe do ta sjellë Shqipërinë më pranë BE-së. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është një shenjë vlerësimi për përpjekjet e bëra deri tani nga vendi ynë dhe është njëkohësisht, një inkurajim për të vazhduar në rrugën e reformave dhe në luftën kundër krimit të organizuar.

Kjo marrëveshje e bën Shqipërinë pjesë të strukturave europiane të angazhuar në luftën kundër krimit të organizuar nëpërmjet hetimeve të përbashkëta mes vendeve anëtare, duke e trajtuar luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit si një çështje të të gjitha vendeve anëtare të BE-së. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje rritet besimi i autoriteteve gjyqësore të shteteve anëtare të BE-së ndaj autoriteteve gjyqësore shqiptare, si partnerë efektivë në luftën kundër krimit të organizuar transnacional dhe terrorizmit. Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Beja!

Fjalën e ka zoti Qefalia si relator i komisionit.

Zoti Qefalia, bëme një kapërcim, sepse kishim parashikuar për të diskutuar të parën marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II.

Ndërkohë, meqë erdhën më herët përfaqësuesit e MD-së, filluam me diskutimin e marrëveshjes me Eurojust-in.

Fjala për ju!

Xhemal Qefalia – Faleminderit zonja kryetare!

Unë nuk kam ç'farë të shtoj më shumë nga sa tha parafolësi, por doja të fokusohesha në dy elemente kryesore. Objektivat kryesore të këtij akti kanë të bëjnë drejtpërdrejt me fuqizimin dhe bashkëpunimin në luftën kundër krimeve të rënda, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Së dyti, kanë të bëjnë me bashkërendimin dhe bashkëfinancimin e veprimeve hetimore të përbashkëta, njëkohësisht edhe me financimin e BE-së. Në këtë kontekst mendoj se është diçka e qartë, që i shërben edhe interesave të sigurisë kombëtare. Mendoj se kjo marrëveshje t'i kalojë seancës dhe i ftoj të gjithë kolegët për ta miratuar atë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia!

Kush nga kolegët ka pyetje?

Po bëj unë një pyetje për përfaqësuesit e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, që është pjesë e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. A keni qenë në dijeni për këtë marrëveshje dhe si do të ndikojë kjo në punën e prokurorisë, në hetimin e krimeve më të rënda?

Jonad Bara – Përshëndetje!

Unë jam Jonad Bara. Kam rreth 14 vjet që punoj pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Si fillim, në të gjitha operacionet që ka zhvilluar Eurojust-i ne kemi qenë si palë e tretë, pra të ftuar nga një vend tjetër, që ishte me të drejta të plota. Sjellja e operacioneve në Shqipëri ka qenë ndër pikat më kryesore të Eurojust-it. Tani është pjesa e formimit të besimit të Eurojust-i, gjë që ka ndodhur. Është vetëm pjesa praktike e finalizimit të detajeve të një prokurori, që do të atashohet atje dhe disa strukturave elektronike, që do të vendosen edhe pranë MD-së, edhe pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Kjo bën që të gjitha vendet e rajonit që kanë hetime në kohë reale, u forcon bashkëpunimin, komunikimin e drejtpërdrejtë, i cili është çelësi i çdo hetimi që zhvillohet ndërmjet disa shteteve. Kjo është pjesa kur ne do të bëhemi anëtarë me të drejta të plota në Eurojust, pra që një prokuror shqiptar mund të kontaktojë me një prokuror të huaj për një çështje që mund të ketë. Do të ketë shkëmbim informacionesh në fazën hetimore apo atë të mëvonshme, të procedimit. Pra, do të jetë ashtu siç i ka raportet gjyqësore të prokurorisë për shkëmbim informacionesh Italia me Gjermaninë, po ashtu do t'i ketë edhe Shqipëria, si në çuarjen, si në marrjen e informacioneve.

Është bërë pjesa e draftit, ku përfaqësues ka qenë drejtoresha e Marrëdhënieve me Jashtë, Odeta. Unë kam qenë nga Prokuroria e Përgjithshme. Këto janë marrëveshje standarde, që Eurojust-i i bën me të gjitha shtetet.

Nga ana jonë nuk ka pasur objeksione. Ka ardhur për mendim pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Është miratuar nga ne dhe i ka kaluar pjesës formale nga Ministria e Drejtësisë deri në nënshkrimin e saj. Kjo është procedura.

Manuela Imeraj - Për të shtuar diçka për ato që tha kolegu. Madje në diskutimin që është bërë në prokurori, ka pasur gjithmonë një përfaqësues të Eurojust-it, meqë Eurojust-i e ka shumë të rëndësishme mbrojtjen e të dhënave personale, në draftimin e një rregulloreje të brendshme të Prokurorisë së Përgjithshme, gjithmonë kemi pasur edhe përfaqësues, edhe asistencën e Eurojust-it për ta bërë këtë rregullore në përputhje me parashikimet që ka Eurojust-i në mbrojtjen e të dhënave personale. Madje, në grupin e punës që është ngritur tani për implementimin e kësaj marrëveshjeje, kemi përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Prokuroria e Përgjithshme.

Është edhe një projekt i BE-së IPA 2017 “Për luftën kundër krimeve të rënda në Ballkanin Perëndimor”. Pra, në çdo hap që është hedhur, ne kemi qenë në dijeni dhe po bashkëpunojmë ngushtë me MD-në për ta implementuar marrëveshjen pas ratifikimit nga parlamenti.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Doni të shtoni diçka zonja Thëngjilli?

Odeta Thëngjilli – Kolegët nga Prokuroria e Përgjithshme thanë gjërat më esenciale. Ne po bashkëpunojmë me të gjitha institucionet. Prej disa vitesh fokusi ishte te mbrojtja e të dhënave. Ne kemi bashkëpunuar me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të

Dhënave Personale dhe pas të gjitha ndryshimeve të ligjeve që kanë bërë, është përshtatur edhe rregullorja, sikurse e tha edhe kolegja nga Prokuroria e Përgjithshme, gjë që ishte një ndër parakushtet deri në nënshkrimin e marrëveshjes. Aktualisht, pritet edhe hapi i fundit. Ne po presim të ratifikohet sa më shpejt me ligj kjo marrëveshje, që të ezaurojmë më pas edhe momentin e fundit, ku pritet ardhja e një grupi të Eurojust-it për inspektimin në Shqipëri lidhur me mbajtjen apo me regjistrimin e të dhënave. Ky do të jetë edhe një kusht tjetër për të pasur ratifikimin e marrëveshjes dhe do të jetë si parakusht edhe në momentin e zbatimit të marrëveshjes.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Më lejoni që ta vazhdoj edhe pak pyetjen time, meqenëse ju keni qenë pjesë e grupit të negocimit të marrëveshjes me Eurojust-in. Në terma praktikë, domethënë e thënë shkurt, thjesht dhe qartë: si do të ndodhë bashkëpunimi me Eurojust-in? Këmbimi i të dhënave do të ndodhë nëpërmjet prokurorit të kontaktit? Për çfarë lloj të dhënash bëhet fjalë?

Meqenëse ju folët për implementim sistemesh, çfarë të dhënash përmbajnë këto sisteme, që mund të shërbejnë si pjesë e bashkëpunimit?

Jonad Bara – Pjesa e bashkëpunimit të Eurojust-it është shumë e thjeshtë. Siç jemi ulur të gjithë rreth një tryeze, secili nga vendet anëtare ka përfaqësuesin e vet dhe një asistent, ku diskutohen çështje të ndryshme. Në rast se pika e kontaktit, prokurori i atashuar në Eurojust, ka kërkesë për një investigim që po ndodh në Itali, ia kërkon palës gjermane ose asaj shqiptare, ai është pikë kontakti dhe di se kë të kontaktojë në Shqipëri, pra nuk ndiqet rruga e letër-porositve të hershme apo edhe komunikimi i drejtpërdrejtë për të cilin do të na duhej të merrnim autorizim nga Ministria e Drejtësisë, si dhe varet mënyra dhe kërkesa e transmetimit të informacioneve, pra për ruajtjen e të dhënave personale nuk duhet të japësh asnjëherë më shumë nga sa të kërkohet. Pra, kur kërkohet informacion për një individ për një llogari bankare në iks bankë, nuk është e thënë që duhet të japësh...

Sepse me letër-porositë e vjetra, që të futemi në thelb, i dërgohet shkresa 30 bankave, vijnë 30 përgjigje dhe i transmetohen 30 shkresa bankash. Pra, me mbrojtje të të dhënave personale nuk do të thotë që do të transmetohet komplet dosja, por vetëm ajo gjë e cila kërkohet. Në implementimin e pajisjeve që do të jenë tek ne, ata janë shumë strikt në ruajtjen e të dhënave personale dhe të dosjes.

Inspektimi do të thotë që rrugët e komunikimit të jenë të sigurta, pra e-mail-et do të jenë të kriptuara ndërmjet prokurorit shqiptar të kontaktit, që do të jetë i atashuar në Eurojust me drejtorinë tonë, që bën shpërndarjen e informacionit dhe është pjesa që pas shkëmbimit të informacionit, ku do të ruhet ky informacion. Përderisa po bëhet fjalë për një komunikim të shpejtë, kjo do të thotë që komunikimi do të jetë elektronik, jo në formë shkresore, përveç rasteve të veçanta, ku do të avancohet me procedimin penal. Ideja është formimi i një *database*, që do të jetë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, pra një serveri të veçantë për komunikimet me Eurojust-in dhe një sekretarie të veçantë që ne e kemi, sekretarinë sekrete, ku kalojnë ekstradimet për të mbajtur një regjistër i veçantë për pjesën e Eurojust-it. Ne do të bëjmë një vizitë studimore me Ministrinë e Drejtësisë në një shtet, si Kroacia, që është futur së fundmi për të parë mënyrën e shkëmbimit të informacionit, vendet ku i ruajnë dhe si është një procedurë normale.

Ermonela Felaj - Ministria e Drejtësisë do jetë në dijeni për çdo komunikim që do të bëhet me Eurojust-in?

Jonad Bara - Po, patjetër.

Ermonela Felaj – Po, dhe një shtesë nga zonja Thëngjilli.

Më pas e ka fjalën zoti Braho.

Odeta Thëngjilli – Ne kemi menduar që përveç grupeve të punës, që janë krijuar në Ministrinë e Drejtësisë dhe pranë Prokurorisë së Përgjithshme, pas ratifikimit me ligj të marrëveshjes, do të krijojmë ndoshta, një grup të përbashkët të bazuar në këtë marrëveshje për të ndjekur implementimin e saj.

Desha të shtoja edhe diçka për ato që tha kolegu i Prokurorisë së Përgjithshme, lidhur me mënyrën se si funksionon Eurojust-i. Qëllimi i Eurojust-it është të ofrojë financim për veprimet hetimore të përbashkëta për çështje të lidhura, që ndodhin në disa shtete njëkohësisht. Mjafton që një nga këto shtete të jetë anëtar i BE-së, për ta filluar edhe për palët e treta. Madje ka edhe shtete që kanë marrëveshje 2-palëshe, si mes SHBA-së dhe të tjerave.

Qëllimi është rakordimi i të gjitha të dhënave, kur hetimi shtrihet në disa shtete. Shtetet e veçanta do të marrin përsipër kryerjen e veprimeve që lidhen me territorin e vendit. Sigurisht, vendi të cilit i kërkohen, ka të drejtën të vendosë kufijtë e të dhënave që transmeton. Përveç kësaj, duhet patjetër që këto të dhëna të transmetohen edhe duke plotësuar kushtet që kërkohen nga Eurojust-i në lidhje me ruajtjen e të dhënave që kanë të bëjnë me Komisionerin për të

Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ne do të përpiqemi që të krijojmë ato kushte sigurie që duhen, siç tha kolegu me regjistër protokolli dhe ndoshta me një server të veçantë, që do të ofrojë më shumë siguri për Eurojust-in.

Ermonela Felaj – Faleminderit! Zoti Braho!

Spartak Braho – Nuk e di se kujt duhet t'i drejtohem nga përfaqësuesit e prokurorisë.

Ermonela Felaj – Jonadit dhe Manuelës.

Spartak Braho – Problemi është ky. Është një fond prej 12 milionë eurosh, i cili nuk është vetëm për prokurorinë, por është edhe për rrethet kufitare, si Pogradeci, Korça, Elbasani. Një pjesë të këtij fondi do ta përdorim për ato qëllime që u relatuan.

Një kazus: Po për hetimin ndaj Gruevskit, a hyjnë në punë këto? Çfarë mund të na thoni në lidhje me këtë çështje? Këtu jemi në Komisionin e Sigurisë. A po heton prokuroria jonë në lidhje me këtë çështje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Një sekondë, se ju jeni thirrur për Eurojust-in!

Spartak Braho – Je e autorizuar ta thuash këtë. E kuptoj, që nuk të prishin punë ty.

Manuela Imeraj – Duke qenë se jemi punonjës të Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, unë nuk mund të them se çfarë po heton prokuroria për atë çështje, por autoritetet maqedonase kanë paraqitur një letër-porosi për të marrë disa informacione lidhur me hyrje-daljet e këtij personi në Republikën e Shqipërisë. Ajo ka ardhur nëpërmjet kanaleve zyrtare. Kështu, nuk mund t'ju them nëse është ekzekutuar apo jo në këtë moment, por kaq është paraqitur. Nuk mund të shtoj gjë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Desha të di lidhjen e Eurojust-it me Europol-in, që janë të dyja marrëveshje të vendit tonë me BE-në, me organizma të caktuara. Çfarë lidhjesh do të kenë këto dy organizma?

Manuela Imeraj - Europol-i është një institucion policor për bashkëpunimin midis policive të vendeve. Eurojust-i është një institucion për bashkëpunimin midis autoriteteve gjyqësore, prokurorisë. Ato patjetër kanë lidhje. Ne kemi përfaqësuesin shqiptar në Europol, i cili është nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në mos gaboj dhe tani po kërkojmë që këtë përfaqësi ta kemi edhe në Eurojust nga prokuroria

Vullnet Sinaj - Ky projektligj është shoqëruar me një marrëveshje. Këtu ju folët për ruajtjen e sekretit të informacionit për të dhënat personale. Po informacionet e klasifikuara si sekret shtetëror, a i keni parashikuar në këtë marrëveshje?

Jonad Bara - Aktualisht, të paktën drejtoria jonë, e cila do të merret me pjesën e shkëmbimit të informacionit me Eurojust-in i ka të gjithë punonjësit të pajisur me certifikatën e sigurisë të modelit C, tepër sekret, pasi ne bëjmë të njëjtën punë, si shpalljen, heqjen nga kërkimi ndërkombëtar të shtetasve tanë jashtë dhe pjesën e kërkesave të ekstradimit nga brenda jashtë vendit. I njëjti qarkullim informacioni do të jetë edhe për Eurojust-in. Vetëm me një transmetim të cunguar të të dhënave personale, pasi shteti transmetues në rastin kur i kërkohet Shqipërisë (që jemi ne), do të mendojë se çfarë është e duhur për t'u nisur dhe jo e gjithë paketa. Mund të kërkohet informacion për Jonadin, por nuk është e nevojshme të kërkohet informacion shtesë, siç mbledhet gjatë bërjes së një pakete të zakonshme letër-porositë për të gjithë familjarët, grupet e interesit të Jonadit apo diçka tjetër, me përjashtim të rastit, kur kërkohet ndryshe nga Eurojust-i.

Manuela Imeraj – Siç u përmend, në prokurori kemi sekretarinë e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror, ku të gjitha dokumentet e klasifikuara në mënyrë të tillë kalojnë në atë sekretari, protokollohen në mënyrën e duhur, ruhen etj. Këtë po mendojmë të bëjmë edhe për Eurojust-in, sepse ata po na kërkojnë që ne të kemi kanale të sigurta komunikimi dhe duhet të mendojmë edhe për serverin, *e-mail*-et, mënyrën se si do të mbahen. Duhet të jenë shumë të sigurt. Këtë qëllim ka edhe grupi i inspektimit të Eurojust-it. Kur të vijë këtu këtë do të kontrollojë, nëse ruhen në mënyrën e duhur, nëse transmetohen të dhënat në mënyrën e duhur. Ne do të përpiqemi ta rrisim më shumë nivelin e sigurisë së këtyre informacioneve për të qenë në përputhje me kërkesat e Eurojust-it dhe për t'i shërbyer sigurisë dhe për të zbatuar ligjin për informacionin e klasifikuar si sekret shtetëror.

Ermonela Felaj – Zonja Thëngjilli!

Odeta Thëngjilli - Faleminderit!

Kur flasim për mbrojtjen e të dhënave personale, dua të sjell në vëmendjen tuaj se për shumicën e shteteve europiane flitet për sekret hetimor dhe për mënyrën e komunikimit më shumë, sesa për nivelin e klasifikimit. Pra, për ta në raportet e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar nuk është kaq e zakonshme që të kenë klasifikimin e akteve. Të paktën në praktikën tonë, shohim se bëhet fjalë për sekret hetimor, por jo për nivelin e sigurisë që ne ndërveprojmë.

Megjithatë, marrëveshja me Eurojust-in përcakton se çdo shtet ka të drejtë të japë ato të dhëna, që ai i mendon se mund t'i japë. Pra, shteti mund të vendosë kufizime në raste të tilla.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se kolegët janë të qartë për përgjigjet e pyetjeve që bënë.

Kalojmë në votimin e projektligjit!

Hedhim në votim në parim këtë projektligj.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projektligj.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Kalojmë te neni 2, që bën fjalë për hyrjen në fuqi.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord në tërësi me këtë projektligj?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”.

Faleminderit, kolegë!

Falënderoj edhe përfaqësuesit e MD-së, dhe ata të Prokurorisë së Përgjithshme për prezencën dhe për të gjitha sqarimet që dhanë!

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.11.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017".

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Luan Harusha, Paulin Sterkaj, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Anduel Xhindi, Klodjana Spahiu dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Elona Hoxha, Myslym Murrizi, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunksi, Isuf Çelaj.

Të ftuar:

Gazmend Barbullushi – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Çekani – Drejtoreshë e Fondeve IPA në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Migena Baholli - Specialiste në Drejtorinë e Traktateve në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017".

Për të bërë prezantimin e këtij projektligji kemi të pranishëm zotin Gazmend Barbullushi, sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, të cilin e falënderoj për prezencën, si dhe zonjën Daniela Çekani, Drejtoreshë e Fondeve IPA në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme. Po kështu, kemi ftuar edhe zonjën Migena Baholli, specialiste në Drejtorinë e Traktateve në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Relator i komisionit për projektligjin është zoti Luan Duzha.

Fjala për ju!

Gazmend Barbullushi – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Po prezantoj shkurtimisht projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017".

Qëllimi i këtij projektligji është të propozojë ratifikimin e marrëveshjes së sipërcituar. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga Komisioni European, më 16.1.2018, nga Maqedonia, është nënshkruar më 13.3.2018, dhe nga Shqipëria, më 28.8.2018.

Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Maqedoni-Shqipëri, 2014-2020, u miratua nga Komisioni me vendimin zbatues C (2014) 9674, të datës 11 dhjetor 2014. Alokimet e vitit 2017 për këtë program financohen nga një grant i Bashkimit European, nëpërmjet instrumentit IPA II, me një vlerë prej 1 190 000 eurosh, për të dyja vendet, por, duke marrë parasysh edhe bashkëfinancimin kombëtar të të dyja shteteve në nivelin 210 000 euro, buxheti i përgjithshëm i programit, për vitin 2017, arrin vlerën e 1 400 000 eurove.

Sqarojmë se, në total, kontributi që do të japë Bashkimi European për zbatimin e përbashkët të programit Maqedoni-Shqipëri, për periudhën 2014-2020, arrin vlerën e 1 190 000 eurove, por alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare ndërmjet vendit tonë, Maqedonisë dhe Komisionit European.

Përfitues të këtij programi janë zonat, si më poshtë vijon:

Në Maqedoni: Rajoni i Pelagonias, i Pologut dhe ai Jugperëndimor.

Në Shqipëri: Qarku i Dibrës, i Elbasanit dhe ai i Korçës.

Programi i bashkëpunimit Maqedoni-Shqipëri ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të forcojë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Ky program, mbështet gjithashtu, shkëmbimin e eksperiencës dhe njohurive midis përfituesve, si dhe përmirësimin e politikave publike mes autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën ku zbatohet.

Duke marrë parasysh aspektet problematike që ndikojnë në ekonominë e rajonit të programit dhe zhvillimin e saj të qëndrueshëm, programi do të fokusohet në 3 prioritet kryesore:

1. Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore;
2. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve;
3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, duke pasur parasysh parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve në këtë fushë.

Thirrja e parë e programit është bërë në shtator të vitit 2016. Buxheti total në thirrjen e parë ka qenë 2 890 000 euro për alokimet e viteve 2014-2015. Kontratat e financimit kanë përfunduar në periudhën tetor 2017- janar 2018 dhe tashmë kanë nisur implementimin e tyre. Janë 8 projekte të evidentuara. Për thirrjen e dytë sqarojmë se do të lançohet së shpejti brenda muajit dhjetor. Prioritetet e kësaj thirrjeje mbeten turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore, mbrojtja e mjedisit, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve.

Ky ishte shumë shkurt informacioni thelbësor për prezantimin e këtij projektligji.

Jemi në dispozicionin tuaj për çdo pyetje dhe informacion tjetër, që mund të kërkon.

Ermonela Felaj – Po, besoj se pasi kemi diskutuar edhe disa marrëveshje të tjera të bashkëpunimit ndërkufitar nëpërmjet fondeve IPA, edhe kolegët janë të qartë për mënyrën se si funksionojnë këto marrëveshje. Kështu, edhe pyetjet mendoj se do të jenë të fokusuar.

Megjithatë, duhet për procedurë t’ia jap fjalën zotit Duzha dhe më tej, nëse ka ndonjë pyetje për t’u ezauruar, patjetër do ta merrni fjalën.

Luan Duzha – Faleminderit, kryetare!

Siç e tha edhe zoti Barbullushi, qëllimi i këtij projektligji është të propozojë marrëveshjen e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të

Maqedonisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, si dhe alokimet e vitit 2017.

Kjo marrëveshje siç u tha, është nënshkruar nga Komisioni European, më 16.1.2018, nga Maqedonia, është nënshkruar më 13.3.2018, dhe nga Shqipëria, më 28.8.2018.

Programi i bashkëpunimit Maqedoni-Shqipëri ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Ky program, mbështet gjithashtu, shkëmbimin e eksperiencës dhe njohurive midis përfituesve, si dhe përmirësimin e politikave publike mes autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën e programit.

Siç u tha, programi bazohet në 3 pika kryesore:

1. Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore;
2. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve;
3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, duke pasur parasysh parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve.

Siç u tha më sipër, kontributi që do të japë Bashkimi European për zbatimin e përbashkët të programit Maqedoni-Shqipëri, për periudhën 2014-2020, arrin vlerën e 11 900 000 eurove, por alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare ndërmjet vendit tonë, Maqedonisë dhe Komisionit European.

Për sa u tha më sipër, i ftoj kolegët ta miratojmë këtë projektligj!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Duzha!

Ka pyetje nga kolegët për të sqaruar ndonjë problematikë të veçantë?

Besoj se sqarimet që dha sekretari i Përgjithshëm ishin shtruese.

Nëse nuk ka pyetje, kalojmë në votim.

Hedhim në votim në parim këtë projektligj.

Kush është dakord në parim me projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017"?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projektligj.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me këtë projektligj? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017".

Kisha një pyetje sa për kuriozitet. Emri i Maqedonisë duhet të jetë kështu për shkak se marrëveshja është negociuar më parë?

Gazmend Barbullushi – Marrëveshja është 3-palëshe, midis nesh, Maqedonisë, siç e njohim ne në marrëdhëniet bilaterale dhe Komisionit Europian, i cili e njeh si FYROM. Kështu ne kemi qenë të detyruar dhe kemi rënë dakord që në krye të herës, që edhe ne në këto raporte duhet ta njohim si të tillë dhe prandaj shkruhet ashtu.

Së fundi, me Marrëveshjen e Prespës është ndryshuar emri. Po të vini re, në firmosjen e palës maqedonase është bërë me një letër shtesë, ku janë reflektuar pikërisht këto ndryshime. Së shpejti do ta kemi emrin tjetër kushtetues të Maqedonisë. Ne jemi të detyruar, sepse është KE-ja, ku është edhe Greqia. Kështu, ne do t'i përmbahemi këtij emërtimi. Kështu është rënë dakord dhe ne kështu e shkruajmë.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Pyeta thjesht për kuriozitet.

Ditë të mbarë!

U lutem kolegëve të rrinë dhe një minutë për të diskutuar për kalendarin e javës së ardhshme!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kolegë,

Nuk mund ta diskutoj pa qenë ju. Ne kemi menduar ta mbyllim axhendën e pikave të kalimit kufitar. Këtë kalendar nuk e kemi vetëm, por e kemi bashkë me OSBE-në. Në këtë rast, do të hyjë në lojë edhe ambasadori zviceran.

MBYLLET MBLEDHJA